



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:043127

Datë: 27.02.2019

Numri i dokumentit: 00234062

**P.nr.47/2017**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bash. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. K. nga fshati B. Komuna e Suharekës për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 325 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe J. D. nga fshati B. Komuna Suharekës, për shkak të veprës penale blerja pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryejen e veprës penale nga neni 345 par.2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2734-4/16, të datës 18.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Prokurorit të Shtetit Musli Gashi dhe të akuzuarve, me datë 12.02.2019 mori dhe publikisht shpalli dhe me date 25.02.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

- 1. S. K.**, nga babai H. dhe nëna R. K. e lindur V., i lindur me 02.08.1988, në fshatin B. Komuna Suharekë, ku edhe tani jeton, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale.
- 2. J. D.**, nga babai R. dhe nëna A. D. e lindur T., i lindur me 24.01.1989, në fshatin B. Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale.

**JANË FAJTOR**

**1.I akuzuari S. K.,**

Sepse me datë 19.10.2016, rreth orës 21:00, në fshatin B. Komuna e Suharekës, pikërisht në oborrin e vëllait të tij, të dëmtuarit A. K., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme – gjeneratorin nga oborri i të dëmtuarit, duke e bartur me dorë, pastaj me një automjet e dërgon në shtëpinë e të akuzuarit J. D., të cilit ia shet në vlerë prej 30.<sup>00</sup> euro.

-këso dore ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPK-së.

**2.I akuzuari J. D.,**

Sepse me datë 19.10.2016, rreth orës 23:00, në fshatin B. Komuna e Suharekë, blen, pranon, fsheh apo në ndonjë mënyrë tjetër siguron sendin apo pasurinë për të cilën ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nëpërmjet telefonit kontakton me të akuzuarin S. K. i cili i ofron për shitje gjeneratorin, e pranon të njëjtin në shtëpinë e tij dhe ia paguan 30.<sup>00</sup> euro.

-këso dore ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76, të KPK-së, dhe nenit 359 par.1 dhe 2 dhe neni 365 të KPP-së, të akuzuarve i u shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit, **S. K.**

Ashtu që i vërteton **dënimin me burg prej 1 (një) muaj**, si dhe dënimin me gjobë prej **100 (njëqind) euro** të cilat dënime nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit, **J. D.**

Ashtu që i vërteton dënimin me burg prej 1 (një) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit lirohen prej shpenzimeve të procedurës conform nenit 453 paragrafi 4 të KPP-së.

I dëmtuar A. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.2734-4/16 të datës 18.01.2017, kundër të akuzuarit S. K., nga fshati B. Komuna Suharekë, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KP-së dhe të akuzuarit J. D. nga fshati B. Komuna e Suharekë për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 të KPK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit Musli Gashi, të akuzuarit kanë theksuar se e kanë kuptuar në tërësi akuzën dhe e kanë pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka patur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarëve.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 19.10.2016, rreth orës 21:00, në fshatin B. Komuna e Suharekës, pikërisht në oborrin e vëllait të tij – të dëmtuarit A. K., i akuzuari S. K., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme – gjeneratorin nga oborri i të dëmtuarit, duke e bartur me dorë, pastaj me një automjet e dërgon në shtëpinë e të akuzuarit J. D., të cilit ia shet në vlerë prej 30.<sup>00</sup> euro. I akuzuari J. D. ka blerë, pranuar dhe fshehur sendin - gjeneratorin për të cilën ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nëpërmjet telefonit ka kontaktuar me të akuzuarin S. K. i cili i

ka ofruar për shitje gjeneratorin, e ka pranuar të njëjtin në shtëpinë e tij dhe ia ka paguar 30.<sup>00</sup> euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale të cilat u vihen në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarëve është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit S. K. formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KP-së dhe në veprimet e të akuzuarit J. D. formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 2 të KP-së.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë fakti se gjer më tani të pa dënuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarve, moshën e të akuzuarve, bashkëpunimin e përgjithshëm të të akuzuarve me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit fillestar, andaj gjykata i shqiptoi të akuzuarit S. K. dënimin me kusht, duke ia caktuar dënimin me gjobë në shumë prej 100 euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, dhe të akuzuarit J. D. i shqiptoi dënimin me kusht duke ia caktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, me bindje se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i duhur ndëshkimor që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori në kuptim të nenit 453 par.4 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**P.nr.47/2017 të dt. 25.02.2019**

**Bashk.Profesional**  
**Feim Bytyqi**

**Gjyqtari**  
**Qemal Suka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimi, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.